



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	20 DPK
Nr. i tag Broj stranica Nr. pagus	02
Nr. Prot. Bi. Prot. Prot No.	01-3488/15
Data Datiuim Date	22.10.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.10.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllt rasti me nr. AKK – 03 – 02-2205/15, për z. **Artan Gashi**, Drejtor në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Pejës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03 –02 - 2205/15, për zyrtarin e lartë z. Artan Gashi, Drejtor në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Pejës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë z. Gashi është hetuar për konflikt interesit sepse krahas ushtrimit të funksionit publik të drejtorit në Komunën e Pejës, ka qenë person i autorizuar në biznesin privat N.T. "ARTEH".

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) fillimisht i ka dërguar shkresën zyrtare me të cilën e ka njoftuar për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës zyrtari i lartë është takuar me zyrtarët e Agjencisë.

Në takim z. Gashi është njoftuar me kufizimet në ushtrimin e funksioneve menaxheriale, krahas ushtrimit të funksionit publik dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit. Ai ka premtuar që në afat sa më të shpejt do të shmang konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, (DPKI 03-02-3054/15), të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se z. Gashi është larguar nga pozita menaxheriale në biznesin privat N.T. "ARTEH". Me këtë ai ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Hasan Preteni

